



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

KGJK.nr.511/2022
Datë: 27 dhjetor 2022

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 dhe 33 të Ligjit nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, në mbledhjen 301-të, të mbajtur me datë 27 dhjetor 2022, merr këtë:

V E N D I M

- I. Miratohet Plani i Përgjithshëm i personelit për gjyqtar dhe administratën gjyqësore për vitin 2023, që përfshinë të gjitha nivelet e gjykatave.
- II. Obligohet Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të KGJK-së, që të përgatis dhe të sjell për miratim në Këshill planin për shpalljen e pozitave të lira për rekrutim.
- III. Vendimi hyn në fuqi me datë 27 dhjetor 2022.

A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, ka përgatitur Planin për shpërndarjen e pozitave të lira për punonjës mbështetës sipas buxhetit të lejuar për vitin 2023.

Këshilli, ka shqyrtuar dhe diskutuar lidhur me propozimin e paraqitur nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore rreth analizës sa i përket gjendjes aktuale në sistemin gjyqësor, nevojës për shtimin e numrit të punonjësve profesional dhe zvogëlimin e numrit të punonjësve teknik-mbështetës në gjykata. Po ashtu, Këshilli vlerësoj të dhënat e Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore se konfirmojnë se zbatimi i këtij vendimi ndihmon në përmirësimin e performancës në përgjithësi dhe nuk paraqet vështirësi buxhetore.

Pas shqyrtimit të propozimit, Këshilli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Albert ZOGAJ,
Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës



Kopje e vendimit i dërgohet:

-
- Sekretariatit të KGJK-së, si dhe
- Arkivit.